

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                             |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Analiza e DW: Partitë ekstremiste po lulëzojnë dhe kjo i tremb njerëzit                                                                                                                                                     |
| ADRESA  | <a href="https://boldnews.al/2026/09/26/analiza-e-dw-partite-ekstremiste-po-lulezojne-dhe-kjo-i-tremb-njerezit/">https://boldnews.al/2026/09/26/analiza-e-dw-partite-ekstremiste-po-lulezojne-dhe-kjo-i-tremb-njerezit/</a> |
| BURIMI  | boldnews.al                                                                                                                                                                                                                 |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                      |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 12:04:45 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 12:00:30 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | e32711324ec39432f459e21c32d02e9b65a02bf0a3bd318816ebbf2bfd199167 |
| TEKSTI     | 404a889d583bc1159da3a78bd34ec297169b378b69c65be2242a001ac2a37d64 |
| PAMJA      | 0f6a2f3e3b360898700651dd45edb89c019abc425c4fd402ba0cb76fb554a436 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | bee4ac0f529f87a3e672c336a0654aa6b4f4255c08cf4a7c2930cc1b365b358e                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bee4ac0f529f87a3e672c336a0654aa6b4f4255c08cf4a7c2930cc1b365b358e>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Fillimi &gt; BOTA

## Analiza e DW: Partitë ekstremiste po lulëzojnë dhe kjo i tremb njerëzit

14:00 : 26/09/2026 në BOTA



Partia ultra e djathtë AfD po forcohet ndjeshëm në Gjermani: në zgjedhjet e 6 shtatorit në Saksoni-Anhalt ajo mori 43,8 përqind të votave, më shumë se kurrë më parë. CDU-ja e kancelarit Friedrich Merz pësoi një humbje të rëndë, duke rënë nga 37,1 përqind në vitin 2021 në 17,2 përqind

Dy javë më vonë, AfD-ja doli sërish e para në Mecklenburg-Pomerani Perëndimore, ndërsa CDU-ja, me vetëm 4,9 përqind, mbeti për herë të parë jashtë parlamentit të një landi.

Në Berlin, ndërkohë, zgjedhjet i fitoi partia E Majta, ndërsa CDU-ja u rendit e dyta dhe AfD-ja e treta.

Sukseset e partive në skajet e spektrit politik po shtojnë shqetësimet për polarizimin në rritje të shoqërisë gjermane.

### Pse po humb terren qendra politike e Gjermanisë

Lexo edhe:

[Krimi i organizuar shqetëson Gjermaninë! Grupet po bëhen më të dhunshme, mes tyre edhe shqiptarë](#)

[Zgjedhjet në dy lande gjermane trondisin Berlinin zyrtar](#)

Gjermanët të shqetësuar për rritjen e partive të ekstremist të djathtë dhe të majtë

Këto zgjedhje në lande tregojnë se partitë në skajet e spektrit politik po forcohen në Gjermani.

### Gjermania ka përvojë me qeveri ekstremiste të djathta dhe të majta: nazistët që e çuan

Gjermaninë në Luftën e Dytë Botërore dhe Partia e Bashkimit Socialist (SED) që sundoi Gjermaninë Lindore nga viti 1949 deri në 1989. Një rikthim të politika ekstreme është një propozim i frikshëm për disa njerëz.

Në një sondazh përfaqësues mujor të quajtur “Çfarë shqetëson botën?”, instituti i sondazheve Ipsos zbuloi se gati një e pesta e gjermanëve (18%) thanë se ishin të shqetësuar për rritjen e ekstremizmit në vend, kur pyetën rreth 1000 persona midis moshës 16 dhe 74 vjeç në mars dhe prill 2026.

#### TË GJITHA



**Analiza e DW: Partitë ekstremiste po lulëzojnë dhe kjo i tremb njerëzit**

14:00 : 26/09/2026



**FOTO/ Tragjedi për familjen shqiptare, motër e vëlla mes viktimave në Athinë**

13:51 : 26/09/2026



**10 ambasadorët e SHBA-së në Tiranë që prej vitit 1991**

13:34 : 26/09/2026



**Aksidenti në Fushë-Krujë ku humbi jetën 19-vjeçari, Forcat e Armatosura: Ishte student i Akademisë**

13:17 : 26/09/2026



**Arabia Saudite nuk e ka përjashtuar zhvillimin e armëve bërthamore**

13:04 : 26/09/2026



**Berisha: Vlera Hyseni u kthye për t'u dhënë reston bashkëpunëtorëve që e tradhtuan**

12:55 : 26/09/2026



**Vodhi makinën dhe përplasi katër automjete, arrestohet 30-vjeçari në Durrës**

12:42 : 26/09/2026

Në përgjithësi, njerëzit në Gjermani janë të shqetësuar për drejtimin ku po shkon vendi i tyre. Në sondazhin e Ipsos-it, 82% thanë se e shihnin Gjermaninë duke u zhvilluar në drejtimin e gabuar.

### **Si të matet gjendja shpirtërore e një vendi**

Të pyesësh njerëzit për frikërat ose shqetësimet e tyre është vetëm një mënyrë për të matur pulsën e kombit.

Por ka shumë mënyra për të matur emocionet politikisht relevante në popull.

Kerstin Pahl, hulumtuese në Institutin Max Planck për Zhvillimin Human në Berlin, i tha DW-së se mundësitë përfshijnë sondazhe sasiore dhe cilësore, si dhe analizimin e diskursit online dhe përmbajtjes që njerëzit ndajnë në mediat sociale. Gjithashtu, është e mundur të lexohet ndjenja e një kombi duke vëzhguar shfaqjet e emocioneve në jetën reale, si protestat dhe demonstratat publike.

Për studiues si Pahl, është gjithashtu interesante të shihet se si çështjet politike mund të simbolizojnë shumë më tepër se kuptimi i tyre material ose faktik.

“Njerëzit mund të shohin infrastrukturën e dobët të rajonit të tyre jo vetëm si dëshmi të mungesës së investimeve, por edhe si një shenjë që janë harruar [nga udhëheqësit e tyre],” tha Pahl.

### **Polarizimi afektiv: Kundërshtarët politikë bëhen armiq**

Fitimi i një përqindjeje më të lartë të votave nga partitë ekstremiste është ajo që shohim në sipërfaqe. Më poshtë qëndrojnë dy lloje polarizimi shoqëror: polarizimi afektiv dhe ideologjik.

“Polarizimi afektiv është një urrejtje në rritje për kundërshtarin politik. Shumica e studimeve e kanë hetuar këtë në kontekstin e SHBA-së midis mbështetësve të Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane,” i tha DW-së Eva Walther, drejtoresha e departamentit të psikologjisë sociale në Universitetin e Trierit në perëndim të Gjermanisë. “Kur kjo ndodh në nivel partie, është një problem.”

Politikanët e partive të ndryshme shpesh duhet të punojnë së bashku dhe të arrijnë kompromise. Ata nuk kanë pse ta pëlqejnë njëri-tjetrin, por duhet të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt, tha Walther. “Kur ky qëndrim me respekt fillon të shembet, ky është një problem për demokracinë,” shtoi ajo.

### **Polarizimi ideologjik: Cili problem është më urgjent?**

Fenomeni tjetër, polarizimi ideologjik, është kur shoqëria ndahet në grupe të veçanta bazuar në çështjet që njerëzit i shohin si problemin më urgjent për ta. Për shembull, shumë njerëz në të djathtën e qendrës politike në Gjermani e shohin migracionin si problemin më të madh, ndërsa shumë njerëz në të majtën e qendrës politike thonë se është kriza klimatike.

Kur ndodhin njëkohësisht situata të ndryshme krize, si migracioni dhe ndryshimi i klimës, studiuesit flasin për një “polikrizë”. Polikrizat intensifikojnë polarizimin ideologjik, duke e bërë edhe më të vështirë për shoqëritë të gjejnë një rrugë të përbashkët përpara.

“Në këtë moment, kemi krizën klimatike që përkon me një krizë për të pasur energji me çmime të përballueshme, më shumë një problem ekonomik,” tha Walther.

Në sytë e atyre për të cilët kriza klimatike është çështja më urgjente, karburantët fosile duhet të braktisen sa më shpejt të jetë e mundur. Por për ata që janë më të shqetësuar për energjinë e përballueshme, mbështetja vetëm të burimet e rinovueshme të energjisë do të rrisë çmimet pa nevojë.

### **Njerëzit duan që politikanët t’i marrin seriozisht problemet e tyre**

Besimi se një politikan është kompetent dhe i gatshëm të përballët me sfidat e mëdha, të veprojë, është një faktor i madh në atë se sa shumë njerëzit i besojnë demokracisë. Por kjo është gjithashtu ajo që i bën krizat që ndërthuren kaq të vështira për t’u menaxhuar. Pa marrë parasysh se cilat probleme përpiqen të zgjidhin së pari politikanët, një pjesë e popullsisë do të zhgënjehet.

“Polikrizat e bëjnë të vështirë për politikanët të veprojnë, gjë që do të thotë se njerëzit kanë

me pak besim se politikanet mund të zgjidhin problemet që u rëndësishme për ta,” tha Walthers.

Partitë ekstremiste të djathta, megjithatë, synojnë të “kënaqin njerëzit duke u dhënë atyre përgjigje të thjeshtuara për probleme komplekse,” shtoi Walthers. Kjo i bën njerëzit të besojnë se politikanët ekstremistë mund t’i zgjidhin problemet e tyre – gjë që nga ana tjetër çon në një polarizim në rritje.

Por politikanët nga partitë demokratike mund të mësojnë nga kërkimet mjekësore për t’u përballur me këtë dilemë, sipas Walthers. “Kur një person ka dhimbje dhe shkon te një mjek, është e rëndësishme që mjeku ta dallojë dhimbjen e pacientit,” tha ajo.

Edhe kur mjeku nuk mund ta zgjidhë menjëherë problemin dhe ta bëjë dhimbjen të zhduket, tregimi i faktit se ai e merr seriozisht problemin dhe pacientin është thelbësor. Dhe e njëjta gjë vlen për politikanët. “Ata duhet t’i bëjnë nevojat e njerëzve prioritetin e parë në punën e tyre të përditshme,” tha Walthers. “Njerëzit duan të shihen, prandaj është e rëndësishme që politikanët ta bëjnë të qartë se i shohin dhe i kuptojnë problemet e tyre.” Qoftë një mjek që nuk arrin ta shohë një pacient apo politikanë që dështojnë në elektorat, pacienti dhe elektorati me shumë gjasa bërtasin — dhe ky është një sinjal që të gjithë mund ta lexojmë./DW

Etiketa: Gjermani parti Partia ultra e djathtë AfD

Lajme të lidhura



Krimi i organizuar shqetëson Gjermaninë! Grupet po bëhen më të dhunshme, mes tyre edhe shqiptarë

16:42 : 21/09/2026



Zgjedhjet në dy lande gjermane trondisin Berlinin zyrtar

08:46 : 21/09/2026



Mbahen zgjedhjet në Berlin dhe Mecklenburg, kancelari Merz nën presion

08:35 : 20/09/2026



Detaje tronditëse nga çifti që mbajtë foshnjën e pajetë për 4 vite në frigorifer

18:41 : 18/09/2026



Sinjal për Rusinë? Gjermania çon deri në 1,000 ushtarë në Lituani

16:46 : 14/09/2026



Atentati ndaj aeroportit gjerman/ Gjurmët që çojnë drejt shërbimit sekret rus

11:28 : 13/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

